



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-klina.org



KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

NR. 030 - 7035/12

DATE 26.10.2012

PJESA B: KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA NR.092/2018

Komuna Kline, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), Nr .Regjistrimit 07000032 dhe Nr. Fiskal 600219366 ,qe perfaqesohet nga Z.Abaz Foniqi –menagjer i z. Prokurimit në një të anë; dhe

"2-TECH- SHPK " NGA PRISHTINA . (ne vazhdim "Kontraktuesi"), "me numer bisnesi 70833379 dhe numer fiskal 600859469 ME PERFAQESUES Z. SHEFKIN GASHI ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për punë e shënuara me poshtë:

ZHVENDOSJA E LANIT DHE PAISJEVE TJERA NGA SERVER ROOM-I
" me numër identifikues: 634-18-6852-236/ 634-18-091-236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda

Përshkrimi i Projektit

Zhvendosja e LAN dhe e Pajisjeve dhe Elementeve të Dhomës së Serverëve brenda objektit të Komunës së Klinës

Komuna e Klinës duhet të bartë Dhomën e Serverëve nga bodrumi i ndërtesës në Katin e parë. Me këtë rast duhet të barten të gjitha pajisjet e instaluar: Ormanët, Serverët, Invertori, Ruterët dhe Switchat, Fibrat optike, Patch paneli i fibrës optike dhe Patch Panelët e LAN me koneksionet e instaluar RJ-45.

¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

Punët të cilat duhet të kryhen:

Punët rreth zhvendosjes së Patch Panelëve

Janë gjithsejt 240 LAN koneksione, të cilat janë të terminuara në 10 Patch Panelë. Këto kablllo duhet të zhvendosen nga Dhoma ekzistuese në Dhomën e re të krijuar. Pas zhvendosjes së UTP kablllove lartë, ato duhet të terminohen sërish në Patch Panel duke ruajtur sa më shumë renditjen e mëparshme. Në fund të procesit duhet të testohen lidhjet. Kompania duhet të zhvendosë edhe Organizatorët e kablllove, të cilat vendosen në Patch panel sipas nevojës së paraqitur (maksimum 10 organizatorë).

Punët e detajuara:

1. Inçizimi i gjendjes dhe shënimi përkatës i kablllove UTP në ormanët ekzistues
2. Deinstalimi i kablllove në Patch Panel
3. Bartja e Patch Panelëve, montimi në Rack në katin e sipërm
4. Depërtimi i pllakës së betonit për bartjen e kablllove
5. Bartja e UTP kablllove nga bodrumi në katin e parë
6. Terminimi i UTP kablllove në Patch Panel
7. Testimi i UTP koneksioneve RJ-45.

Punët rreth zhvendosjes së Invertorit

Punët e detajuara:

1. Deinstalimi i kablllove që lidhin invertorët me bateritë
2. Shënimi përkatës i kablllove dhe baterive për menaxhim të mirë të procesit
3. Pastrimi i Invertorit dhe baterive
4. Bartja e Invertorit dhe baterive në dhomën e re të serverëve
5. Montimi i kablllove dhe vendosja në punë e invertorëve.
6. Testimi i punës së Invertorëve pas lidhjes së pajisjeve.

Punët rreth zhvendosjes së Switchave

Punët e detajuara:

1. Deinstalimi nga dhoma e serverëve në bodrum, shënimi përkatës i kablllove dhe Switch-ave
2. Bartja e Switch-ave nga bodrumi në katin e parë
3. Montimi i Switch-ave në Ormanët në katin e parë, sipas renditjes së caktuar
4. Lëshimi në punë dhe testimi i funksionimit

Punët rreth zhvendosjes së Ormanëve

Punët e detajuara:

1. Deinstalimi nga dhoma e serverëve në bodrum, shënimi përkatës i elementeve të montuara në Orman.
2. Bartja e tre ormanëve nga bodrumi në katin e parë.
3. Montimi i Ormanëve në pozicionet e caktuara sipas projektit të ndërtuar.

Punët rreth zhvendosjes së Serverëve

Punët e detajuara:

1. Deinstalimi serverëve nga dhoma e serverëve në bodrum, shënimi përkatës
2. Incizimi i gjendjes ekzistuese (lidhjet me kablo, mënyra e vendosjes).
3. Bartja e serverëve nga dhoma e serverëve në bodrum deri në vendin e caktuar
4. Montimi adekuat, shënimi përkatës, si dhe vendosja në vendin përkatës në ormanin përkatës.
5. Lëshimi në punë i serverëve dhe testimi i lidhjes prej secilit kompjuter

Punët rreth zhvendosjes së Ruterëve

Punët e detajuara:

1. Deinstalimi Router-ëve nga dhoma e serverëve në bodrum, shënimi përkatës
2. Incizimi i gjendjes ekzistuese (lidhjet me kablo, mënyra e vendosjes).
3. Bartja e Router-ëve nga dhoma e serverëve në bodrum.
4. Instalimi në orman, shënimi përkatës, si dhe vendosja në vendin përkatës në rack-un përkatës.
5. Konfigurimet e nevojshme (nëse paraqitet nevoja) të Routerit në bazë të konfigurimit të ri të rrjetit LAN.
6. Testimi i Routerit pas instalimit

Punët me Fibër Optik

Punët e detajuara:

1. Deinstalimi i Patch panelit të Fibrit Optik dhe shenjimi i saktë i fijeve në përdorim
2. Depërtimi i pllakës së betonit për zhvendosjen e fibrit optik një kat më lartë dhe zhvendosja e fibrit
3. Instalimi i Patch Panelit të Fibrit Optik në dhomën e re të serverëve
4. Spllajsimi dhe Matja e saktë të fijeve të terminuara
5. Shënimi përkatës, vendosja në vendin përkatës në ormanin përkatës dhe testimi i kyçjes së institucioneve që lidhen me fibër optik.

Instalimi i Kondicionerit 12000 BTU

Punët e detajuara:

1. Blerja e Kondicionerit
2. Depërtimi i murit anësor për vendosjen e gypave të kondicionerit
3. Instalimi i Kondicionerit
4. Testimi i Kondicionerit

Kërkesat për Operatorin Ekonomik:

- Për bartjen e pajisjeve nga dhoma e serverëve në bodrum deri në vendin e caktuar, përgjegjësinë për dëmtimet fizike e merr kontraktori.
- Çdo parregullësi e pajisjeve aktive ose pasive të shënohet në ditar (i cili duhet të mbahet) dhe të lajmërohet personi përgjegjës i Komunës.
- Pas punimeve të kryera, secila pajisje duhet të testohet, të vëhet në punë dhe të kontrollohet për ndonjë parregullësi.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve eshte:

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP ² - €	Çmimi total €
1.	Punët rreth zhvendosjes së Patch Panelëve	cope	10	59.00	590.00
2.	Instalimi i Patch Panelëve - 24 porte dhe Terminimi i RJ-45 koneksioneve	Cope	240	4.84	1.162.12
3.	Testimi i secilit koneksion RJ-45 me matës dhe dorëzimi në formë të shtypur	cope	240	2.36	566.40
4.	Depërtime muri	cope	2	35.40	70.80
5.	Punët rreth zhvendosjes së Invertorit	cope	1	59.00	59.00
6.	Punët rreth zhvendosjes së Switchave	cope	7	10.62	74.34
7.	Punët rreth zhvendosjes së Ormanëve	Cope	3	29.50	88.50
8.	Zhvendosja Organizatorëve te kablllove UTP për ormanët	cope	10	7.08	70.80
9.	Punët rreth zhvendosjes së Serverëve	cope	2	35.40	70.80
10.	Punët rreth zhvendosjes së Ruterëve	Cope	1	17.70	17.70
11.	Punët me Fibër Optik	cope	4	20.06	80.24
12.	Funzim Instalimi i Kondicionerit 12000 BTU	cope	1	407.10	407.10
Totali i Përgjithshëm:					3.256.80

3.256.80 €; Tremijedyqindepesedhjetegjashteeuroe80/100)

2.3. Kontrata do te jete kontrate publike per pune sipas ofertes financiare te ofertes :

Planin dinamik i kryerjes së punimeve të parashikuara, i cili duhet të përfundohet për 3 ditë kalendarike.

² Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.

Bartja e pajisjeve dhe lëshimi ne pune duhet te kryhet brenda ditës dhe me orarë te caktuar, dita e premte prej ores 16, dita e shtune nga ora 08:00 deri 17:00 ne max, në mënyrë që të mos pengohet puna e rregullt e administratës së Komunës së Klinës ditën e hënë.

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.2 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.5. Punet qe do te jene objekt i kesaj pjese te kontartes do te jene :

2.6 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.-sipas situacioneve dhe kryerjeve te puneve, me raport nga mengjeri i projektit, raport pranimi dhe raportin detal te menagjimit te kontrates .:

Pas përfundimit te punimeve me Raport nga Komisioni dhe Fature

.Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
 - (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
 - (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- 3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4

Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

4.5. Per menaxhim te kontrates bazuar ne nenin 81 te LPP 04/L-42 merohet Drejtoria Komonale e ADMINISTRATES – Drejtori sipas Funksionit ,z. BINAK SYLAJ

Për Autoritetin Kontraktues
Komuna Kline

Për Kontraktuesin

"2-TECH SHPK " PRISHTINE

Emri:	Abaz Foniqi		SHEFKIIN GASHI	
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit		DREJTOR	
Nënshkrimi:			SH. GASHI	
Data:	26.10.2018		26.10.2018	
Vula:				

